



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SH.A
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
DREJTORIA LIGJORE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(PAS PROCESIT TË ANKIMIT)

Datë 01.06.2024

Drejtuar: Operatorit “Adel CO” sh.p.k. NUIS L22117021M
Me adresë: Rr. “Myslym Keta”, Ish-Rezerva e Shtetit, Tiranë

Procedura e prokurimit/lotit: **Loti i II-të: “Blerje Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 “Traktor” (3 kopje)”.**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **Loti i II-të: “Blerje Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 “Traktor” (3 kopje)”, REF-84246-10-18-2023.**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Loti i II-të: “Blerje Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 “Traktor” (3 kopje)”, me vlerë 65,464,000 (gjashtëdhjetë e pesë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) Lekë, pa TVSH. Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”.** Kohëzgjatja e kontratës, 6 (gjashtë) muaj kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike datë 23.10.2023, nr. 87.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- **oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X**

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik **InfoSoft Office SH.P.K.** NUIS J62426002Q me vlerë të ofertës **36,750,200** (tridhjetë e gjashtë milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë e dyqind) Lekë pa TVSH;
2. Operatori ekonomik **“Dynamix Group” SH.P.K.** NUIS L42306022T. me vlerë të ofertës **39,500,000** (tridhjetë e nëntë milion e pesëqind mijë) Lekë pa TVSH;

3. Operatori ekonomik “**Marketing & Distribution**” SH.P.K. NUIS J72124001N me vlerë të ofertës **44,800,000** (dyzet e katër million e tetëqind mijë) Lekë; pa TVSH;
4. Operatori ekonomik “**Inpress**” SH.P.K. NUIS L52122014L me vlerë të ofertës **47,040,000** (dyzet e shtatë milion e dyzet mijë) Lekë pa TVSH.
5. Operatori ekonomik “**Kristalina KH**” SH.P.K. NUIS K11501002D me vlerë të ofertës **64,700,000** (gjashtëdhjetë e katër milion e shtatëqind mijë) Lekë pa TVSH.
6. Operatori ekonomik “**Adel CO**” SH.P.K. NUIS L2111021M me vlerë të ofertës **63,192,000** (gjashtëdhjetë e tre milion e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) Lekë pa TVSH;

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- Operatori “**Dynamix Group**” SH.P.K. NUIS L42306022T;
- Operatori “**InfoSoft Office**” SH.P.K. NUIS J62426002Q;
- Operatori “**Inpress**” SH.P.K. NUIS L52122014L
- Operatori “**Marketing & Distribution**” SH.P.K. NUIS J72124001N

- Operatori ekonomik “**Dynamix Group**” SH.P.K. NUIS L42306022T. skualifikohet për arsye se nuk përmbushet plotësisht kriteret për kapacitetin teknike për kualifikim dhe konkretisht:

- Nuk plotëson pikën **2.3.5** të Dokumentave Standarte të Tenderit ku citohet se ; Operatorët ekonomikë të cilët ofrojnë Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje) si produkt i gatshëm/final, duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar së bashku me skedën teknike të produktit të ofertuar, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje).

Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

Operatorët ekonomikë prodhues të produktit të gatshëm/final duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar për lëndën e parë të përdorur për prodhimin e letrës traktor, si dhe duhet të paraqesin skedën teknike për letrën e përdorur gjatë prodhimit të letrës traktor, të certifikuar nga prodhuesi, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të kërkuara sipas specifikimeve për produktin Letër A5, “Traktor” (3 kopje); Letër A4 “Traktor” (3 kopje).

Skeda teknike të paraqitet për të dyja llojet e letrës traktor në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

Në çdo rast duhet vërtetuar lidhja e prodhuesit dhe/ose distributorit të autorizuar të letrës lënde e parë me prodhuesin e letrës traktor.

Nga dokumentat e paraqitura rezulton se janë paraqitur vetëm specifikimet teknike të printuara dhe firmosura dhe jo skedë teknike si kërkohet në pikën e sipërcituar në DST.

- Në përmbushje të pikës **2.3.6** të shtojca 7, të dokumentave të tenderit, nuk ka paraqitur *dorazi mostra/modele për produktet e përcaktuara në sasinë dhe grafikun e lëvrimit dhe sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor (një fije Letër A5 "Traktor" (3 kopje) dhe një fije Letër A4 "Traktor" (3 kopje)).*
- Operatori ekonomik **"InfoSoft Office"** SH.P.K. NUIS J62426002Q skualifikohet për arsye se nuk përmbush plotësisht kriteret kualifikuese të kapaciteteve teknike për kualifikim dhe konkretisht:

*Referuar pikës III. 9. të Vendimit të KPP-së Nr. 500/2024 datë 10.05.2024 vlerëson se nuk përmbushet pika **2.3.6. e shtojca 7, të DST-së pasi: duke krahasuar rezultatet e analizave të kryera nga laboratorit "Eko – Studio – Projekt" SHPK, në lidhje mostrën e paraqitur nga operatori ekonomik "Infosoft Office" SHPK, për sa i përket peshës së Letër traktor A4 dhe A5 për të treja kopjet në veçanti ,e secilës nga fijet, (duke përfshirë edhe marzhin e gabimit 0.1 g sipas laboratorit), me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, rezulton se mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik "Infosoft Office" SHPK nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Në këto kushte KPP gjykon, se mostra, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të siguruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të përcaktuar në dokumentet e tenderit përbën shkak për skualifikim.***

- Operatori ekonomik **"Inpress"** sh.p.k. NUIS L52122014L skualifikohet për arsye se nuk përmbush plotësisht kriteret kualifikuese të kapaciteteve teknike për kualifikim dhe konkretisht:

*Referuar pikës III. 4. të Vendimit të KPP-së Nr. 500/2024 datë 10.05.2024 vlerëson se nuk përmbushet pika **2.3.6. e shtojca 7, të DST-së pasi: duke krahasuar rezultatet e analizave të kryera nga laboratorit "Eko – Studio – Projekt" SHPK, në lidhje mostrën e paraqitur nga operatori ekonomik "Inpress" SHPK, për sa i përket peshës së Letër traktor A4 dhe A5 për të treja kopjet në veçanti ,e secilës nga fijet, (duke përfshirë edhe marzhin e gabimit 0.1 g sipas laboratorit), me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, rezulton se mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik "Inpress" SHPK nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor.***

- Operatori ekonomik **"Marketing&Distribution"** sh.p.k. NUIS J72124001N skualifikohet për arsye se nuk përmbush plotësisht kriteret kualifikuese të kapaciteteve teknike për kualifikim dhe konkretisht:

*Referuar pikës III. 6. të Vendimit të KPP-së Nr. 500/2024 datë 10.05.2024 vlerëson se nuk përmbushet pika **2.3.6. e shtojca 7, të DST-së pasi: duke krahasuar rezultatet e analizave të***

kryera nga laboratorit “Eko – Studio – Projekt” SHPK, në lidhje mostrën e paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, për sa i përket peshës së Letër traktor A4 dhe A5 për të treja kopjet në veçanti ,e secilës nga fjet, (duke përfshirë edhe marzhin e gabimit 0.1 g sipas laboratorit), me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, rezulton se mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Në këto kushte KPP gjykon, se mostra, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të siguruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të përcaktuar në dokumentet e tenderit përbën shkak për skualifikim.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik **Operatorit “Adel CO” sh.p.k. NUIS L22117021M**, me adresë: **Rr. “Myslym Keta”, Ish-Rezerva e Shtetit, Tiranë**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të totale prej **63,192,000** (gjashtëdhjetë e e tre milion e njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) Lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoriteti Kontraktor “Posta Shqiptare” sh.a., Adr.: Rr. “Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë**, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **[64,700,000** (gjashtëdhjetë e katër milion e shtatëqind mijë) Lekë pa TVSH], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesat: Ka patur ankesë nga operatorët **“Adel CO” sh.p.k. NUIS L22117021M**; **“Inpress” sh.p.k. NUIS L52122014L**; **“Marketing&Distribution” sh.p.k. NUIS J72124001N** dhe **“Infosoft Office” sh.p.k. NUIS J62426002Q**.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni i Prokurimit Publik me Vendimin Nr. 500/2024 datë 10.05.2024 ka vendosur:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Adel Co” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë”, me Nr. REF-84246-10-18-2023 me objekt: “Loti II “Blerje Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 "Traktor" (3 kopje)”, me fond limit 65,464,000 (gjashtëdhjetë e pesë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) leke pa TVSH, zhvilluar me datë 20-11-2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SH.A..
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

3. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit .
4. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Infosoft Office” SHPK, “Inpress” SHPK dhe “Marketing & Distribution” SHPK dhe, dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke i skualifikuar këta operatorë ekonomikë.
5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.

Autoriteti Kontraktor “Posta Shqiptare” sh.a., në përmbushje të Vendimit **Nr. 500/2024 datë 10.05.2024**, ka bërë rivlerësimin e ofertave në SPE dhe në zbatim të pikës 5, të vendimit të sipërcituar, ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, se ka korrigjuar shkeljet e konstatuara nga KPP-ja.

Komisioni i Prokurimit Publik me **Vendimin Nr. 582/2024 datë 28.05.2024**, të publikuar në Sistemin Elektronik të Ankesave të Komisionit të Prokurimit Publik, ka vendosur:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me REF-84246-10-18-2023, Loti i II-të: “Blerje Letër A5 "Traktor" (3 kopje), Letër A4 "Traktor" (3 kopje)”, me fond limit: 65,464,000 (gjashtëdhjetë e pesë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) Lekë, pa TVSH., zhvilluar me datë 20/11/2023 nga autoriteti kontraktor “Posta Shqiptare” sh.a.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Ardit Demiri